

20150100167

**LIGJ PËR PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË  
MAQEDONISË TË OBLIGIMEVE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR  
PROJEKTIN "FURNIZIM ME MJETE TË REJA TËRHEQËSE DHE TË TËRHEQURA  
NË HM TRANSPORTI SHA-SHKUP", QË DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS  
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE HM TRANSPORTI SHA-  
SHKUP**

Neni 1

Në Ligjin për garanci të Republikës së Maqedonisë të obligimeve sipas Marrëveshjes për hua për Projektin "Furnizim me mjete të reja tërheqëse dhe të tërhequra në HM Transporti SHA-Shkup", që do të lidhet ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe HM Transporti SHA-Shkup ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 121/12), pas nenit 5 shtohet neni i ri 5-a, si vijon:

"Neni 5-a

Qarkullimi i të mirave dhe shërbimeve i kryer ndaj HM Transporti SHA-Shkup, të dedikuara për realizimin e Projektit "Furnizim me mjete të reja tërheqëse dhe të tërhequra në HM Transporti SHA-Shkup", të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtën e heqjes së tatimit paraprak.

Importi i të mirave/shërbimeve nga HM Transporti SHA-Shkup, të dedikuara për realizimin e Projektit "Furnizim me mjete të reja tërheqëse dhe të tërhequra në HM Transporti SHA-Shkup", të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe detyrime tatimore, si dhe nga akciza gjatë importit të automobilave dhe vajrave minerale.

Për qarkullimin e kryer ndaj HM Transporti SHA-Shkup, për qëllime të realizimit të Projektit "Furnizim me mjete të reja tërheqëse dhe të tërhequra në HM Transporti SHA-Shkup", të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji, për të cilin i njëjti është obligues tatimor sipas nenit 32 pika 4 dhe nenit 32-a të Ligjit për tatim mbi vlerën e shtuar, lirohet nga obligimi për llogaritjen dhe pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Obliguesi tatimor që kryen qarkullim të liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar sipas paragrafit (1) të këtij neni, detyrimisht përveç emrit (emërtimit) të pranuesit të së mirës ose shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë i shënon edhe emërtimin e projektit edhe emërtimin e Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji.

HM Transporti SHA-Shkup gjatë importit të të mirave të liruara sipas paragrafit (2) të këtij neni, organit kompetent doganor detyrimisht i dorëzon kopje të Marrëveshjes për hua nga neni 1 i këtij ligji dhe deklaratë se të mirat/shërbimet e importuara janë të dedikuara për realizimin e Projektit "Furnizim me mjete të reja tërheqëse dhe të tërhequra në HM Transporti SHA-Shkup", të financuar me Marrëveshje për hua nga neni 1 i këtij ligji."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".